



# Si të siguroni burimet për t'u veçuar të sigurt në shtëpi

NYC Test & Trace Corps do të sigurohet që cilido që ka pasur COVID-19 apo që ka qenë në kontakt me dikë me COVID-19, të ketë burimet për t'u veçuar në mënyrë të sigurt në shtëpi. Për këtë gjë, ne punojmë me orientuesit e burimeve nga organizatat me bazë komuniteti në lagjen tuaj. Ata mund t'ju ndihmojnë të përfitonit nga burimet në lagjen tuaj.

## Burimet përfshijnë:

- + dërgesat ushqimore
- + lejen e paguar nga punëdhënësi juaj
- + barnat
- + sigurimin shëndetësor
- + shërbimet bazë (korrentin, ujin, gazin)
- + ndihmën për të marrë urdhër formal për karantinë
- + një ofrues të kujdesit parësor
- + mbështetje për shëndetin mendor
- + ndihmë kundër dhunës në familje
- + shërbime shoqërore
- + burime strehimi dhe për të pastrehë
- + përkujdesje për kafshët shtëpiake
- + paketë përkujdesjeje me pajime të mjaftueshme mbrojtëse për një shtëpi me tre vetë për karantinë/izolim për 10 ditë.
- + dhe shumë të tjera!

Për të kontaktuar me orientuesin e burimeve, telefononi nr. **212-540-6923** për t'u lidhur me burimet që t'ju ndihmojnë me rikuperimin tuaj nga COVID. Nëse lini një postë zanore jashtë orarit të punës, orientuesi i burimeve do t'ju telefonojë ditën tjetër të punës.

**Komunikimi me një orientues të burimeve nuk jua cenon mundësinë e aplikimit për qëndrim të përhershëm (apo "kartën e gjelbër").** Nëse keni pyetje për statusin tuaj të imigrimit, telefonojini linjës së ActionNYC në nr. 1-800-354-0365 dhe thoni "public charge" (faturim publik) nga ora 9 a.m. deri në 6 p.m., nga e hëna në të premte.

**Organizatat partnere përfshijnë:** BronxWorks, CUNY dhe Chinese-American Planning Council (CPC) në partneritet me Korean Community Services.

Informacioni që NYC Test & Trace Corps merr përmes gjurmimit të kontakteve është konfidencial dhe i mbrojtur sipas Kodit Shëndetësor të qytetit të Nju-Jorkut. Databaza e Corps nuk do të lidhet me ndonjë databazë autoritetesh ligjzbatuese. NYC Test & Trace Corps do të ruajë në formë të siguruar çfarëdo informacioni që marrim dhe atë do ta përdorë vetëm personeli i autorizuar për qëllimin e kufizuar të mbrojtjes së shëndetit publik.

Për më shumë, vizitoni [testandtrace.nyc](https://testandtrace.nyc)

NYC  
HEALTH+  
HOSPITALS

Test & Trace  
Corps